

VENDIM
Nr. 176, datë 8.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 149, DATË 18.2.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E
BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, pika 5, 75, pika 3, të ligjit nr. 70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 149, datë 18.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit operacional me grada të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, që përmendet në pikën 1 të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Lidhja nr. 2, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit pa grada dhe mbështetës”, që përmendet në pikën 5 të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT
OPERACIONAL, ME GRADA TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME
DHE ANKESAT

Nr.	Grada	Funksionet organike	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>
1	Asistent	Ndihmëspecialist në provë në trupën operacionale	47000	9,000
2	Asistent i parë	Ndihmëspecialist në trupën operacionale	52000	9,000
3	Kryeasistent	Drejtues grupi/ ndihmëspecialist në trupën operacionale	57000	9,000
4	Inspektor	Specialist në nivel vendor Specialist i trupës operacionale	68000	8,000
5	Inspektor i parë	Specialist në nivel vendor Specialist në nivel qendror në trupën operacionale	80800	8,000
6	Kryeinspektor	Shef sektori në nivel vendor Specialist në nivel qendror	86100	10,000
7	Drejtues i shërbimit	Shef sektori në nivel qendror Specialist në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor	92400	10,000
	Drejtues i parë i shërbimit	Drejtor drejtorie në nivel qendror Shef sektori në nivel qendror Drejtor drejtorie në nivel vendor	103950	10,000
9	Zv/drejtor i përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	107100	17,000
10	Drejtor i përgjithshëm	Drejtor i përgjithshëm	116550	22,000

LIDHJA NR. 2
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT PA GRADA DHE MBËSHTETËS
TË SHËRBIMIT

Nr.	Klasifikimi i niveleve	Funksionet organike	Kategoria e pagës (propozohet)	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa e pozicionit (propozohet)	Shtesa për natyrë të veçantë pune (propozohet)
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>	<i>7</i>
1	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit	II-b	1	2%	100,000	
		Drejtor në nivel qendror (shërbimet mbështetëse)	III-a	1	2%	80,800	
2	Punonjës të nivelit të ulët drejtues	Shef sektori në nivel qendror (në drejtorinë e inspektimit dhe në sektorin operacional)	III-a/1	1	2%	70,500	14,000
		Shef sektori në nivel qendror (në drejtorinë e shërbimeve mbështetëse)	III-a/1	1	2%	70,500	
3	Punonjës	Specialist (në sektorin operacional)	III-b	1	2%	61,000	10,000

	të nivelit ekzekutiv	Specialist (drejtorinë e inspektimit)	III-b	1	2%	61,000	5,000
		Specialist në nivel qendror	III-b	1	2%	61,000	
			IV-a	1 ose 2	2%	49,000	
			IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	38,000	